



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Planuar / Dorezuar Priljenen/Prodato Received/Delivry	11-06	2021	1	viti god year
Organ /Rjeshtja Organ./Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
Služba	3029/2021		1/1	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova
Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo

A.nr.424/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti - kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani, anëtarë, si dhe Zyle Millaku-Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.424/2021 të datës 20.05.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë Rr."Uglarit" Kompleksi Altrade, Linda 11 Nr.19 kati 3 Komuna e Fushë Kosovës, kundër organit të punësimit Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, në çështjen juridike „kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 11.06.2021, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET POSHTË si e palejuar ankesa me numër A.nr.424/2021 e datës 20.05.2021, e parashtruar nga

A r s y e t i m

Ankuesi punësuar në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, në pozitë "Zyrtar për komunikim dhe mirëmbajtje të web faqes", në Departamentin e Zyrës së Kryeshefit Ekzekutiv, në Njësinë e Zyrës për Informimit, me koeficient gjashtë (6), sipas Kontratës së marrëdhënies së punës të datës 11.12.2011, të cilit me datë 13.04.2012 me Vendimit me nr. Protokolli 1586 të nxjerrë nga Kryeshefi Ekzekutiv i është caktuar koeficienti shtatë(7), dhe i është nxjerrë Akt emërimi me nr.protokolli 4519 me datë 19.10.2012. Po ashtu me datë 07.03.2014 Kryeshefi Ekzekutiv ka nxjerrë Vendimin me numër Ref.AUV.01-104/2014, me të cilin ankuesit i caktohet koeficienti tetë(8), duke nxjerrë Akt emërimin e datës 10.03.2014 me nr.protokolli 954/1.

Ankuesi me datë 09.12.2020 ka parashtruar kërkesën me nr.protokolli 7691 tek Zëvendës Drejtori Ekzekutiv në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, për aprovimin e shtesës në pagën bazë duke u bazuar në Vendimin e Qeverisë Nr.02/30 të datës 08.10.2008, sipas aneksit 1 pika Nr.7, retroaktive nga momenti i themelimit të marrëdhënies së punës, duke bashkangjitur kontratën e punës dhe akt emërimin, në pozitë "Zyrtar për komunikim dhe mirëmbajtje të web faqes".

Me datë 10.12.2020 Zëvendës Drejtori Ekzekutiv në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, ka nxjerrë Vendimin Ref.AUV-01-817/2020 me numër protokoll 7685 me të cilin ankuesit i është aprovuar kërkesa e datës 09.12.2020, për periudhën janar-dhjetor 2020, kurse pjesa e mbetur do të kompensohet sipas mundësive buxhetore të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë.

Me datë 05.02.2021 Zëvendës Drejtori Ekzekutiv në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë ka parashtruar kërkesë me nr.protokoll 1232, tek Sekretari i Përgjithshëm i ZKM-së, për realizimin e shtesës në pagë bazë sipas Vendimit të Qeverisë nr.02/30 të datës 08.10.2008, për ankuesin që të hynë në listën e pagave me shtesë, me arsyetimin se Institucion i kemi njohur të drejtën e shtesën në pagën bazë.

Me datë 20.05.2021 ankuesi, ka parashtruar ankesë me numër protokoll 2492/21 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendime ankimore për zbatimin e Vendimit Ref.AUV-01-817/2020 me numër protokoll 7685 , me të cilin i është njohur i shtesa në pagën bazë dhe deri me tani nuk i ka marrë mjetet financiare .

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 24.05.2021 ka dërguar kërkesë për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, të cilën përgjigje Këshilli e ka pranuar me datë 04.06.2021, me shkresat e bashkangjitura prej 1/13 faqe.

Kolegji për marrjen e vendimit meritor administroj këto prova; Ankesën A.nr.424/2021 të datës 20.05.2021 drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kontratë e marrëdhënies së punës e datës 11.12.2011; Vendim i datës 13.04.2012 me nr. Protokoll 1586 i nxjerrë nga Kryeshefi Ekzekutiv, për caktim të koeficienti shtatë(7); Akt emërimi me nr.protokoll 4519 i datës 19.10.2012; Vendim i datës 07.03.2014 i nxjerrë nga Kryeshefi Ekzekutiv, me numër Ref.AUV.01-104/2014, për caktim të koeficientit tetë(8); Akt emërimi i datës 10.03.2014 me nr.protokolluar me nr.954/1; Kërkesë e datës 09.12.2020 me nr.protokoll 7691 drejtuar Zëvendës Drejtori Ekzekutiv në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, për aprovimin e shtesës në pagën; Vendimin e Qeverisë Nr.02/30 të datës 08.10.2008; Formularit për pagesa retroaktive i datës 10.12.2020, për ankuesin; Kërkesë e datës 05.02.2021 nga Zëvendës Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë me nr.protokoll 1232, drejtuar tek Sekretari i Përgjithshëm i ZKM-së, për realizimin e shtesës në pagë për ankuesin; Përgjigje ne ankese e datës 04.06.2021, me shkresat e bashkangjitura: Përshkrimi i detyrave të punës i datës 31.12.2011; Diplomë Universitare Nr.837 i datës 18.02.2009; Diplomë Universitare Nr.742 i datës 11.10.2016; Vendimi Nr.02/39 i datës 08.10.2008, me Aneks të bashkangjitur; E-mail i datës 10.12.2020; E-mail i datës 09.12.2020; Konfirmimi nr. Protokoll 7686 i disponshmërisë së mjeteve buxhetore i datës 10.12.2020; Raporti përmbledhës i kontrollit buxhetor i datës 09.12.2020; E-mail i datës 03.06.2021; E-mail i datë 22.02.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të të gjithave shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit *është e pa lejuar, sepse është e parashtruar jashtë afatit të paraparë ligjor.*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se ankuesi, me datë 20.05.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për zbatimin e Vendimit Ref.AUV-01-817/2020 të datës 10.12.2020 me numër protokoll 7685 , me të cilin i është njohur shtesa në pagën bazë sepse deri me tani, nuk i janë realizuar mjetet financiare të aprovuara nga Zëvendës Drejtori Ekzekutiv në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pasi ka shqyrtuar provat e lëndës veç e veç ka konstatuar se ankuesi, me datë 20.05.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, jashtë afatit ligjor të përcaktuar në nenin 127 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *" 1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ"*, sepse në rastin konkret ankuesi nga data 10.12.2020 është njoftuar me Vendimin Ref.AUV-01-817/2020 të protokolluar me numër 7685 të nxjerrë nga Zëvendës Drejtori Ekzekutiv në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, me të cilin i është aprovuar shtesa në pagën bazë dhe deri me datë 01.02.2021 nuk i është bërë realizimi i pagesës në llogarinë e bankës, nga kjo datë ankuesi e ka kuptuar se nuk i është bërë pagesa e mjeteve financiare dhe ka filluar ti rrjedh afati prej 30 ditësh, për të parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Po ashtu, bazuar në dispozitën ligjore të nenit 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publik, ku përcaktohet se: *" 3. Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji. E drejta e ankimit në KPMSHC i njihet edhe çdo kandidati në një procedurë pranimit në Shërbimin Civil. Pas shterimit të drejtës së ankimit në KPMSHC, mund të inicohet konflikt administrativ në gjykatën kompetente për çështjet administrative"*, i cili ligj nga data 09.07.2020 është në fuqi sipas Aktgjykimit GJK-KO203/19-AKV të Gjykatës Kushtetuese, dhe mbi këtë bazë ky ligj e ka shfuqizuar Ligjin për Shërbimin Civil nr. 03/L-149 dhe çdo dispozit tjera që wshtw në kundërshtim me këtë ligj, rrjedhimisht shfuqizohet çdo akt tjetër që është në kundërshtim me këtë ligj, dhe me dispozitat transitorë të nenin 83 për dispozitat transitorë, të këtij ligji, ku përcakton se: *"1. Nëpunësi civil në marrëdhënie pune në Shërbimin Civil, në pajtim me Ligjin e Shërbimit Civil (03/L-149) dhe që mban një pozitë ekuivalente me pozitën e nëpunësve civilë sa i përket funksioneve dhe përgjegjësi, konsiderohet nëpunës civil sipas nenit 2, paragrafi 3 të këtij ligji, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji"*, dhe se ankuesi mbanë pozitën e nëpunësit civil në Shërbimin Civil të Kosovës .

Bazuar në provat e lëndës është konstatuar se ankuesi lidhur me realizimin e të drejtës së tij ka parashtruar ankesës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 20.05.2021, e cila është ushtruar jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.



KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.424/2021, datë 11.06.2021.

Zyle Millaku-GOJNOVCI

Procesmbajtëse

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë;
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë dhe
- Arkivit të KPMShCK-së.

